EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

LAJME TË MIRA NGA

SUNDIMI I LIGJIT

RAPORTI TREMUJOR NR. 6



“DHUNA NDAJ MOSHATARËVE NUK ËSHTË OK – KA ARDHUR KOHA QË SHOQËRIA TË VETËDIJËSOHET!”

VIZITË STUDIMORE NË SLLOVENI

SIGURIMI I NJË PROCESI GJITHËPËRFSHIRËS DHE TRANSPARENT PËR NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË LIGJIT PËR KËSHILLIN GJYQËSOR

FORUMI I IMPULSEVE: RRJETËZIM PËR PAVARËSI TË INSTITUCIONEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SHKURT 2025

KLAUZOLA E PËRGJEGJËSISË:
KY RAPORT FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN. PËRMBAJTJA ËSHTË PËRGJEGJËSI E LUDWIG BOLTZMANN GESELLSCHAFT – INSTITUTI PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT (LBI-GMR) DHE NË TË NUK SHPREHEN QËNDRIMET E BASHKIMIT EVROPIAN.

Financuar nga
Bashkimi Evropian

PARATHËNIE



Diter SHINDLAUER

Udhëheqës Ekipi, Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

"Po e shfrytëzojmë këtë botim që të vazhdojmë të mbajmë lartë moralin dhe etikën e besimit në një arsye të shëndoshë për ndryshim, reforma dhe proces të vazhdueshëm përmirësimi. Për të bërë këtë, do të flasim mbi hapat e bëra përpara dhe do të festojmë për to në mënyrë që të mos humbasin në lajmet jo aq pozitive që janë gjithmonë më të zëshme."

I dashur lexues,

Në raportin e tremujorit të gjashtë po ju sjellim përsëri një sërë lajmesh të mira mbi një sërë aspektesh të sundimit të ligjit.
Do të njiheni me angazhimet e vazhdueshme për të forcuar sistemin juridik në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, do të shihni se si vazhdon lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit me shumë sfida për institucionet që zbatojnë ligjet që kanë për qëllim të shtojnë dhe t'iu përshtaten në mënyrë konstante zhvillimeve të fundit.

Në këtë botim, do të doja të theksoj sidomos çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe fushatën kundër dhunës ndaj moshatarëve nëpër shkolla. Në këtë botim mund të gjeni raportin mbi hapat e fundit që janë ndërmarrë për përpilim të një Plani të ri Veprimi për të Drejtat e Fëmijëve në nivel kombëtar. Pasi ky i fundit të implementohet, do të jetë një arritje tjetër për fëmijët në Maqedoninë e Veriut. Një nga parimet e të drejtave të fëmijëve thotë që përveç që duhet mbrojtur, fëmijët duhet edhe të dëgjohen, dhe mendimet dhe idetë e tyre duhet të integrohen në çdo çështje që lidhet me ta. Ky projekt ka përfshirë edhe fëmijët në procesin e hartimit të planit të ri të veprimit dhe disa nga fëmijët na u bënë edhe aleatë gjatë fillimit të fushatës kundër fenomenit të përhapur të bullizmit dhe dhunës në shkollë.

PARATHËNIE

Videoja me mesazhin kryesor ‘‘është koha të veprojmë kundër dhunës ndaj moshatarëve’’ u transmetua nëpër televizone dhe rrjete sociale në dhjetor të 2024. Në këtë botim, do të njiheni me Draganën, Nikollën, Janën dhe Ivanin, nxënës në shkollën e mesme “Nikolla Karev” që ishin pjesë e fushatës dhe e videos. Pas fushatës, redaktorja dhe zyrtarja e vizibilitetit Kristina Vesiq takoi këta nxënës në shkollën e tyre ku edhe i intervistoi lidhur me fushatën, përvojat e tyre dhe zgjidhjet që lidhen me dhunën mes moshatarëve dhe bullizmin. Për mendimin tim nxënësit kanë dhënë përgjigje të shkëlqyera, duke dëshmuar vetëdije të lartë dhe një sens zgjuarsie që gjendet rrallë tek të rinjtë nëpër shoqëritë tona. Me fjalë të tjera, nxënësit e shpjegojnë rëndësinë e parandalimit, arsyet se pse rrjetet sociale mund të jenë vend i rrezikshëm dhe arsyen se pse është e nevojshme të solidarizohemi me viktimën. Përfundimi më mbresëlënës që ata japin është mbase ajo që bullizmi shumë shpesh perceptohet si diçka normale si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit. Nxënësit ngrejnë zërin për të shpërndarë një mesazh të qartë: “Jo! Bullizmi nuk është diçka normale. Është një problem serioz që lë pasoja. Duhet të ngrihemi kundër kësaj dukurie.” Unë jam plotësisht dakord. Kur po lexoja këto fjalë thënë nga këta të rinj maqedonas kaq të dedikuar, të ndjeshëm dhe të fortë, u mbusha me frymëzim dhe shpresë dhe uroj që po këtë ta ndjeni edhe ju. S’na mbetet gjë tjetër përveç t’i falenderojmë nga zemra për bashkëpunimin dhe angazhimin që treguan.

Poashtu, në këtë raport do të gjeni storje nga Forumi ynë interaktiv për të Drejtat e Njeriut, i quajtur Forumi i Impulseve dhe një intervistë në grup me disa nga ekspertët e projektit tonë nga Komponenti i Parë që mbështesin sistemin gjyqësor, me të cilët flasim hollësisht mbi rolet që kanë, punën në ekip dhe sukseset e arrritura.

Uroj që të kënaqeni dhe të merrni informacione të reja nga ky raport.

Shijoni lajmet e mira!



Diter Shindlauer
Udhëheqës Ekipi

JU PREZANTOJMË ME:

“TË NDALOJMË DHUNËN MES MOSHATARËVE”

Në bashkëpunim me Avokatin e Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, filluam fushatën për rritje të vetëdijes për të promovuar të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtje të fëmijëve nga dhuna mes moshatarëve.

VIZITA STUDIMORE

Me këtë ngjarje u theksua roli i rëndësishëm i ekspertëve sllovenë që janë pjesë aktive në projektin për forcimin e sundimit të ligjit në Maqedoninë e Veriut, me një fokus të veçantë në luftën kundër krimit të organizuar dhe rritjen e kapaciteteve në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Maqedoninë e Veriut.

FORUMI I IMPULSEVE

Forumi i Impulseve: Rrjetëzimi për pavarësi të institucioneve për të drejtat e njeriut bëri bashkë 30 përfaqësues nga institucione të pavarura, organet e shtetit, organizata joqeveritare, organizatat qytetare, projekte ndërkombëtare, akademia, dhe gjykatat nën temën ‘’të pimë kafe me një qëllim“.

Të flasim pak për...

- Forumi i Impulseve: Rrjetëzimi për pavarësinë e institucioneve për të drejtat e njeriut
- Rritja e pavarësisë, llogaridhënies dhe besimit publik tek gjyqësori në Maqedoninë e Veriut
- Punëtori e mbajtur me sukses mbi luftën kundër veprave penale korruptive
- Sigurimi i procesit gjithëpërfshirës dhe transparent për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor
- Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies në Këshillin e Prokurorëve Publikë
- Vizitë pune në Republikën e Sllovenisë për të promovuar bashkëpunimin dhe luftën kundër krimit të organizuar
- Hartimi i Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2024-2028)
- “Dhuna ndaj moshatarëve nuk është OK – ka ardhur koha që shoqëria të vetëdijësohet!”

Forumi i Impulseve: Rrjetëzimi mes institucioneve të të drejtave të njeriut

Në 4 dhjetor, 2024, në Laboratorium u mbajt “Forumi i Impulseve: Rrjetëzimi mes institucioneve të të drejtave të njeriut”. Kjo ngjarje me pjesëmarrje të madhe bëri bashkë mbi 30 përfaqësues nga institucione të pavarura, organe qeveritare, organizata të shoqërisë civile, projekte ndërkombëtare, akademia, dhe gjykatat për të diskutuar mbi temën e ‘’kafesë me një qëllim të caktuar.” Me metodën e Kafesë Botërore, ky forum krijoi hapësirë dinamike për diskutime thelbësore dhe këmbim të përvojave mbi aspektet heterogjene që ka pavarësia.



Sasa Jankovic, Ekspert Ndërkombëtar në Projektin Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit

Forumi filloi me prezantimet e hollësishme nga Tena Simonovic Einualter, Avokate e Popullit e Republikës së Kroacisë, dhe Sasha Jankoviç, Ekspert Ndërkombëtar i Projektit të BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit dhe ish Avokat Populli i Republikës së Serbisë. Këto prezantime vendosën bazën për eksplorim të detajuar të sfidave dhe mundësive që kanë të bëjnë me pavarësinë e institucioneve që merren me të drejtat e njeriut.

Pjesëmarrësit vlerësuan pavarësinë e përgjithshme të institucioneve për të drejtat e njeriut në Maqedoni me notën 2 nga 5, ku 1 është “jo të pavarura” kurse 5 “plotësisht të pavarura.” Me këtë vlerësim theksohet rëndësia e të pasurit dialog të vazhdueshëm dhe aktivitet për të forcuar autonominë institucionale.

Përfundimet kryesore nga diskutimet:

- **Integriteti ka rëndësi të madhe:** Çdo individ brenda një institucioni për të drejtat e njeriut duhet të ketë integritet. Edhepse udhëheqësit shihen si pjesa thelbësore, edhe kontributi i të gjithë të punësuarve dhe kënaqësia e tyre duhet të shihen si po aq të rëndësishme.
- **Zëri në shoqëri:** Institucionet e të drejtave të njeriut duhet të jenë ato që ngrejnë zërin brenda komuniteteve ku veprojnë.
- **Pavarësia si proces:** Arritja e pavarësisë përbën një udhëtim të vazhdueshëm dhe jo një gjendje fikse. Mbështetja publike është një kujdes kritik për pavarësinë institucionale.
- **Gjithëpërfshirja sjell qëndrueshmëri:** Shumëllojshmëria e brendshme forcon institucionet ndaj presioneve të jashtme. Udhëheqësit që marrin parasysh mendimet e të punësuarve ushqejnë kulturë të përfshirjes që nxit qëndrueshmërinë.

Tena Simonovic Einualter theksoi vlerën që ka qasja me pjesëmarrje që ajo përdori vetë gjatë këtij forumi: “Kjo metodë është sidomos efektive për të diskutuar pavarësinë. Përmes saj evitohet imponimi i përkufizimeve të jashtme duke u fokusuar në identifikimin e zgjidhjeve që i përshtaten kontekstit dhe që përputhen me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane.”



Tena Simonovic Einualter, Avokate e Popullit e Republikës së Kroacisë

I frymëzuar nga fryma bashkëpunuese e kësaj ngjarjeje, njëri nga pjesëmarrësit thotë, “Ne kemi pozita që kanë fuqinë të ndikojnë në jetët e të tjerëve. E kemi për detyrë të jemi shembull dhe të punojmë së bashku për të ruajtur standardet më të larta të institucioneve të të drejtave të njeriut.”

Me këtë forum u shënua një hap i rëndësishëm drejt mbështetjes së rrjetëzimit, mësimit me këmbim përvojash, dhe veprimeve kolektive për të rritur pavarësinë dhe efektivitetin e institucioneve të të drejtave të njeriut.





Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











Forcimi i pavarësisë, llogaridhënies dhe besimit të opinionit në gjyqësorin e Maqedonisë së Veriut

Në rrugëtimin e Maqedonisë së Veriut drejt integrimit në BE, element thelbësor vazhdon të jetë forcimi i gjyqësorit. Për të trajtuar sfidat ekzistuese ndaj pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit, siç edhe theksohet nëpër raportet e fundit dhe sondazhet e besimit publik, Projekti i BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit, bashkë me Institutin CEELI dhe Akademinë Nacionale të Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë mbajti konferencën për gjyqësorin në Shkup në datat 19 dhe 20 nëntor, 2024.

Kjo konferencë u mbajt në Gjykatën Supreme dhe në të morën pjesë 60 palë relevante të gjyqësorit për të diskutuar çështjet kritike më të cilat ballafaqohet gjyqësori. Me fjalë hyrëse u drejtuan mes të tjerëve, Irina Trajkoska Strezoski, Drejtoreshë e Akademisë së Gjykatësve, e cila theksoi rëndësinë që kanë trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve, Besa Ademi, Kryetare e Gjykatës Supreme, që theksoi nevojën për rritje të transparencës, dhe Vesna Dameva, Kryetare e Këshillit Gjyqësor që u fokusua tek nevoja për reforma të brendshme. Fjalët hyrëse vendosën bazën për diskutimet dyditore që pasuan.



Besa Ademi, Kryetare e Gjykatës Supreme

Në këtë konferencë fokusi ishte tek forcimi i llogaridhënies përmes mekanizmave të ndryshëm, përfshirë këtu masat diciplinore, etikën, proceset e vetingut, duke i dhënë prioritet ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit. Një element i rëndësishëm ishte krahasimi i përvojave me ato të vendeve të tjera për tu informuar mbi një rrugë që duhet ndjekur për reforma në Maqedoninë e Veriut.

Ndër sesionet më të rëndësishme ishte ai me titull ‘’Gjykatësit mbrojnë sundimin e ligjit dhe pavarësinë e gjyqësorit’’, me prezantues nga Bullgaria, Hungaria, Polonia, dhe Moldavia. Këta gjykatës ndanë sfidat me të cilat ballafaqohet gjyqësori nëpër vendet e tyre për të ruajtur pavarësinë dhe sundimin e ligjit, dhe diskutuan mbi ndikimet negative që kanë fushatat negative, kërcënimet, sulmet, ngrirja e pagave, pensionimet e hershme të detyrueshme, emërimet politike, dhe procedurat diciplinore. Gjykatësit theksuan rëndësinë që kanë uniteti, solidariteti dhe angazhimi publik në luftën kundër këtyre sfidave.

Kjo konferencë shërbeu si platformë dialogu për këmbim dhe promovim të njohurive më të mira mbi sfidat dhe zgjidhjet e mundshme për të rritur llogaridhënien, pavarësinë dhe besimin publik tek gjyqësori në Maqedoninë e Veriut. Pjesëmarrja aktive e gjykatësve dhe ekspertëve nga mbarë Evropa theksoi përpjekjet e fuqishme për të mbështetur progresin e Maqedonisë së Veriut drejt një sistemi gjyqësor më të rreptë dhe më të besueshëm. Në të ardhmen, njohuritë dhe lidhjet e formuara gjatë këtij takimi do të shërbejnë për të nxitur reforma domethënëse dhe të qëndrueshme në gjyqësorin e vendit.



U realizua me sukses Punëtoria për Luftën Kundër Veprave Penale Korruptive

Punëtoria "Udhëzime dhe instruksione për zbulim efektiv dhe hetim të veprave penale korruptive'', që u mbajt në 10 dhjetor, 2024, bëri bashkë zyrtarë të zbatimit të ligjit për të forcuar strategjitë e trajtimit të korrupsionit. Kështu u mundësua platformë për këmbim të njohurive, identifikim të zgjidhjeve praktike, dhe forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional. Me këtë punëtori synohet që pjesëmarrësve t'iu ofrohen mjete për të forcuar proceset hetimore dhe për të trajtuar në mënyrë efektive sfidat që lidhen me korrupsionin.

U prezantuan udhëzime gjithëpërfshirëse për të rritur detektimin dhe hetimin e shkeljeve korruptive, bashkë me zbatim të detajuar të planeve dhe strategjive për monitorim dhe ekzekutim. Pjesëmarrësit ndanë praktikat më të mira, u përfshinë në diskutime të hapura dhe shqyrtuan raste praktike studimore për të kuptuar më mirë kompleksitetin e rasteve korruptive.



Workshop mbi Luftën kundër Krimit Korrupsion

Ekspertët Mr. Mojca Kuzmicki, dhe Dr. David Smolej ndanë ekspertizën e tyrë, duke ofruar metodologji dhe njohuri të rëndësishme për hetime të suksesshme të korrupsionit. Prezantimet e tyre theksuan rëndësinë e qasjes së koordinuar për të trajtuar korrupsionin.

Kjo punëtori u ofroi pjesëmarrësve njohuri të zbatueshme, që ritheksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe qasjes proaktive. Me këtë ngjarje u shënua një hap i rëndësishëm përpara për të ndërtuar themelet e drejtësisë dhe transparencës, duke kontribuar kështu në përpjekjet e vazhdueshme për shoqëri pa korrupsion.



Ekspertët e projektit nga Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit, Dr. David Smolej dhe Mr. Mojca Kuzmicki, dhe Udhëheqësi i komponentit Robert Splajt


онија
вда
nia
e

Sigurimi i procesit gjithëpërfshirës dhe transparent për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Në nëntor dhe dhjetor të 2024, projekti i BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit mbështeti Ministrinë e Drejtësisë gjatë organizimit të një sërë konsultave publike për përmirësim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Qëllimi që synohet me këto konsulta është të siguruarit që dëgjohet zëri i gjykatësve dhe ekspertëve lidhur me propozim ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe që ekspertiza e tyre të pasqyrohet në versionin e fundit të këtyre propozim ndryshimeve. Një proces gjithëpërfshirës dhe transparent është parakusht i domosdoshëm për të pasur ligj më të mirë.

Ministria e Drejtësisë filloi procesin e ndryshimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor në mënyrë që të trajtojë rekomandimet e Misionit të Revizionit mbi funksionimin e Këshillit Gjyqësor. Ekspertët e kontraktuar nga Bashkimi Evropian bënë identifikimin e mangësive sistemike në kornizën ligjore që trajton Këshillin Gjyqësor.



Konsulta publike për përmirësim të Ligjit për Këshillin Gjyqësor

Ministria e Drejtësisë caktoi grupin e punës që përpiloi propozim ndrsyhimet që u ndanë dhe u diskutuan nëpër takime të ndryshme. Konsultat u mbajtën në formë të diskutimeve ku çdo pjesëmarrës kishte mundësinë të kontribuojë duke dhënë mendimin e tij/saj. U organizuan pesë tryeza diskutimi, dy në Shkup dhe nga një në Manastir, Gostivar dhe Shtip. Mbi 100 gjykatës nga çdo instancë e gjyqeve, dhe nga çdo rajon i apelit, bashkë me ekspertë të mirënjohur ligjorë dhanë kontribut aktiv në këto konsulta.

Mës temave kryesore që u diskutuan ishin edhe: kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, statusi dhe llogaridhënia e anëtarëve, transparenca e Këshillit dhe procedurat diciplinore kundër gjykatësve. Pjesëmarrësit në këto tryeza diskutimi ofruan rekomandime të vlefshme dhe konstruktive që jepen bashkë në një raport të gjerë përpiluar nga ekspertët e projektit. Ky raport do i prezantohet Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtim të mëtejshëm.



Projekti Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit inkurajon Ministrinë e Drejtësisë që të shqyrtojë me kujdes komenetet dhe rekomandimet që jepen nga gjykatësit dhe ekspertët. Ky projekt do të vazhdojë mbështetjen që ofron gjatë procesit të përpilimit të ligjit për tu siguruar që versioni përfundimtar i Ligjit për Këshillin Gjyqësor merr parasysh Rekomandimet nga Misioni i Revizionit dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato evropiane.

Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së Këshillit të Prokurorëve Publikë

Transparenca dhe llogaridhënia arrihen me qasje të pandërprerë në informacionin publik. Duke informuar rregullisht opinionin mbi mënyrat e zbatimit të procedurave dhe mënyrat se si merren vendimet, Këshilli i Prokurorëve Publikë ka një rol të rëndësishëm në formimin e opinionit publik dhe në të fituarit e besimit të qytetarëve në institucione.

Duke i pasur parasysh këto parime të rëndësishme, projekti mbështeti misionin ndërkombëtar të ekspertëve për vlerësim të kornizës ligjore dhe praktikave momentale të Këshillit të Prokurorëve Publikë, me qëllim që të rritet transparenca dhe llogaridhënia sipas standardeve të BE-së.

Njëri nga ekspertët ndërkombëtarë (prokuror publik me përvojë të gjatë) përgatiti raportin me vlerësim të praktikave momentale të Këshillit, duke u bazuar nëpër takime dhe intervista zhvilluar me përfaqësuesit e Këshillit të Prokurorëve Publikë, me Zyrën e Prokurorit Publik, me anëtarët e Shoqatës së Prokurorëve Publikë, me mediet dhe shoqërinë civile.

Ky raport, ku jepen përfundime dhe rekomandime specifike se si të përmirësohet gjendja, iu prezantua anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë në një tryezë diskutimi udhëhequr nga eksperti i jashtëm. Diskutimi kishte në fokus mënyrat se si të forcohet transparenca dhe llogaridhënia e punës së Këshillit.

Anëtarët e Këshillit mirëpritën konkluzat e ekspertit, dhe u dakorduan me zell që të inicojnë procesin e zbatimit të rekomandimeve duke i futur ato nëpër akte nënligjore dhe duke i zbatuar në punën e përditshme të Këshillit. Ky është një përmirësim i dukshëm i gjendjes, duke pasur parasysh që transparenca dhe llogaridhënia janë shtyllat kryesore për ndërtim të besimit në sistemin e prokurorisë publike.



Tryeza diskutimi me anëtarët e Këshillit të Prokurorëve Publikë

Vizitë studimore në Republikën e Sllovenisë për të promovuar bashkëpunimin dhe luftën kundër krimit të organizuar

Delegacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut, udhëhequr nga Drejtori i Byrosë për Siguri Publike, Z. Aleksandar Janev, zhvilloi vizitën e parë të punës në Republikën e Sllovenisë në 13 nëntor, 2024, organizuar në kuadër të projektit ''Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit''. Gjatë kësaj vizite u theksua roli i rëndësishëm i ekspertëve sllovenë që marrin pjesë në mënyrë aktive në projekt për të forcuar sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut, me fokus në luftën kundër krimit të organizuar duke rritur kështu kapacitetet e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vizitës, Drejtori Janev takoi Ministrin e Brendshëm të Republikës së Sllovenisë, Z. Boshtar Pokluka, si dhe Drejtorin Gjeneral të Policisë së Sllovenisë, Z. Senad Jusiç. Gjatë këtyre takimeve u konfirmua mbështetja që ofron Republika e Sllovenisë në procesin që ndjek Maqedonia e Veriut për tu harmonizuar me Bashkimin Evropian. Me këto takime u vërtetua bashkëpunimi brenda projektit, përfshirë ekspertët sllovenë që morën pjesë në mënyrë aktive, duke kontribuar me njohuritë dhe përvojën e tyre për të përmirësuar proceset në vend, sidomos në fushën e punës së policisë dhe shërbimeve të inteligjencës.



Drejtori i Byrosë për Siguri Publike i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Z. Aleksandar Janev dhe Ministri i Brendshëm i Republikës së Sllovenisë, Z. Boshtar Pokljuk

Si pjesë e vizitës u organizua edhe një punëtori nga Ministria e Brendshme e Sllovenisë, ku pjesëmarrësit u njohën me praktikat e avancuara në operacionet e fshehta dhe inteligjencën penale. Kjo punëtori ofroi këmbim të praktikave të mira dhe promovim të bashkëpunimit ndër-institucional, që ndikoi pozitivisht në ndryshimet strukturore në Ministrinë e Brendshme të Maqedonisë së Veriut.

Ky projekt ka një rol të rëndësishëm në këto përpjekje, ngaqë krijon platforma për të këmbyer njohuri dhe resurse. Kontributi ynë i vazhdueshëm vërteton angazhimin për ndërtim të një force policore me integritet dhe profesionalizëm dhe përshtatje me vlerat evropiane.


REPUBLIC OF SLOVENIA
MINISTRY OF THE INTERIOR
POLICE
REPUBLIKA SLOVENIJA
MINISTRSTVO ZA NOTRANJE ZADEVE
POLICIJA

Hartimi i Planit Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2024-2028)

Fëmijët janë zemra e çdo shoqërie. Ata përfaqësojnë potencialin dhe rrugën drejt një të ardhmeje më të mirë. Trajtimi i nevojave të tyre, ndjeshmërive dhe të drejtave ka shumë rëndësi për të pasur një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Plani Nacional i Veprimit (PNV) për të Drejtat e Fëmijëve përbën një kornizë të strukturar dhe mjet për të siguruar mbrojtje gjithëpërfshirëse, promovim dhe realizim të këtyre të drejtave.

Projekti i BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit në mënyrë aktive ka mbështetur Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë, dhe Rinisë për të përpiluar Planin Nacional të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2024-2028). Ky plan u përgatit përgjatë një procesi gjithëpërfshirës ku u bënë bashkë palë të ndryshme relevante nga institucione të ndryshme duke siguruar edhe përfshirjen e fëmijëve.

ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS DHE BASHKËPUNUES

PNV u hartua nga një grup pune multidiciplinor me përfaqësues nga:

- **Ministritë e Qeverisë:** Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë; Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Financave; Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme.
- **Njësitë e Qeverisë:** Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë, Instituti i Aktiviteteve Shoqërore, dhe Enti Shtetëror i Statistikave.
- **Organet e pavarura:** Avokati i Popullit, UNICEF, dhe organizatat e shoqërisë civile (OJQ).

Ajo që e dalloi këtë proces ishte përfshirja aktive e fëmijëve, që i bëri ata pjesë thelbësore në përpilimin e politikave që kanë të bëjnë me vetë ata.

VIZIONET DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Qëllimi primar i PNV është përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve, të siguruarit që ata rriten në mjedis të sigurt dhe mjedis që iu mundëson të kultivohen. Me këtë plan synohet të bëhet harmonizimi i politikave të vendit me kornizat më të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë këtu:

- **Garancia Evropiane për Fëmijët**
- Rekomandimet nga **Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve**
- **Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm (QZHQ)**

Ky harmonizim integron PNV në **Strategjinë Nacionale për Zhvillim 2024-2044** në formën e saj më të gjerë, duke rikonfirmuar koherencën dhe ndikimin afatgjat që ka.



Keti Jandrijeska Jovanova, eksperte e projektit të BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit

FUSHAT ME PRIORITET PËR VEPRIM

Përmes konsultimeve të zgjeruara me institucionet e vendit, organizatat e shoqërisë civile, dhe fëmijët, PNV bën identifikimin e tetë fushave prioritare për avancim të të drejtave të njeriut:

1. Trajtimi i **varfërisë tek fëmijët**
2. Promovimi i **të drejtave dhe lirive të njeriut**
3. Lufta kundër **dhunës ndaj fëmijëve**
4. Sigurimi i **mjedisit familjar dhe kujdesit alternativ mbështetës**
5. Forcimi i **mbështetjes për fëmijët me pengesa në zhvillim**
6. Rritja **e qasjes në shëndetësi dhe përfitime shëndetësore**
7. Forcimi i **sistemeve arsimore**
8. Ndërtimi i kapaciteteve të vendit për zbatim efektiv të **monitorimit të të drejtave të fëmijëve**



Keti Jandrijeska Jovanova, eksperte e projektit të BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit

Tek këto prioritete pasqyrohet angazhimi për të tranzituar nga retorikat politikbërëse në strategji të vërteta që mbështesin zhvillim e përgjithshëm, fuqizimin dhe mirëqenien e çdo fëmije.

QEVERISJA DHE MBIKËQYRJA

Për të siguruar zbatim efektiv, PNV parasheh themelimin e **Komisionit Nacional për Mbrojtje të të Drejtave të Fëmijëve.** Ky organ do të bëjë koordinimin dhe do të mbikëqyrë zbatimin e PNV dhe do të monitorojë harmonizimin me të drejtat që përcakton **Konventa e të Drejtave të Fëmijëve.** Poashtu, me mbështetjen që ofron projekti i BE-së për mbështetje të sundimit të ligjit, do të përpilohet edhe një instrument për monitorim të të drejtave të fëmijëve, i cili do të përdoret nga Komisioni gjatë punës.
Prezantimi dhe hapat e radhës

Propozim Plani Nacional i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2024-2028) u prezantua oficialisht para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në datë **21 nëntor, 2024,** gjatë takimit të Grupit Sektorial të Punës për Arsim, Punësim dhe Politika Sociale.

Në këtë prezantim u synua vëmendja e përfaqësuesve nga disa ministri relevante, ambasadorë, partnerë socialë, shoqëria civile, dhe komuniteti i donatorëve me qëllim që të fitohet mbështetje sa më e madhe për PNV.
Sa i përket planit të zhvillimit, Plani i fundit Nacional i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (PNV DF) skadoi në 2015. Që atëherë, të drejtat e fëmijëve janë trajtuar përmes planeve të veçanta të veprimit lidhur me tema të caktuara, e jo në kuadër të ndonjë PNV për DF gjithëpërfshirës. Pa mbështetjen e këtij Projekti, nuk i dihej se kur do të bëhej një PNV i tillë për DF. Versioni i fundit i PNV DF u nda me Ministrinë e Politikës Sociale dhe Zhvillimin e Rinisë (MPSZHR), që më tutje duhet ta dorëzojë në Qeveri për tu aprovuar. Afati për dorëzim dhe votim do të caktohet në përputhje me diskutimet mes Ministrit të MPSZHR dhe Qeverisë, me atë që PNV DF pritet të aprovohoet gjatë muajve në vijim. Pasi të jetë miratuar, projekti do të mbështesë MPSZHR gjatë zbatimit të aktiviteteve të caktuara dhe gjatë krijimit të ndonjë mjeti për të monitoruar PNV DF.

Përfundimi

PNV 2024-2028 përbën një qasje transformative mbi të drejtat e njeriut, që bazohet në gjithëpërfshirje dhe që mbështetet nga provat, si dhe përputhet me standardet ndërkombëtare. Duke i dhënë prioritet mirëqenies dhe fuqizimit të secilit fëmijë, ky plan vendos një themel të qëndrueshëm për një të ardhme më të sigurt dhe me prosperitet për çdo fëmijë.



EU SUPPORT FOR RULE OF LAW

Република Северна Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ
Republika e Maqedonisë së Veriut
AVOKATI I POPULLIT
Republic of North Macedonia
OMBUDSMAN

ДА ГО ПРЕКИНЕМЕ КРУГОТ НА НАСИЛСТВОТО

Финансирано од Европска Унија

ЕУ со ТЕБЕ

“Dhuna mes moshatarëve nuk është OK – është koha që shoqëria të vetëdijësohet!”

Ivan Ivanov, Dragana Janjic, Nikola Todorovski dhe Jana Georgievska kanë ide të qartë se ç’është dhuna mes moshatarëve. Ata janë të vetëdijshëm që kjo gjë ndodh në mjedisin ku jetojnë, në shkollën e tyre të mesme ‘’Nikolla Karev’’, por poashtu dëshmojnë maturi të madhe në mënyrën se si kërkojnë zgjidhjet. Ajo që më habiti më së shumti gjatë bisedës me këta të rinj ishte vullneti i tyre për të pasur rol aktiv në luftën kundër dhunës, qoftë kjo dhunë brenda shkollës, në mjedisin që i rrethon apo në internet.

Biseda me ta ma rikujtoi që ndryshimi i vërtetë fillon tek vetë të rinjtë – kur ata nxiten që të ngrejnë zërin, kur zëri i tyre dëgjohet dhe kur iu ofrohet mbështetje për të vepruar. Fushata ‘’T’i japim fund dhunës mes moshatarëve’’ në të cilën morën pjesë është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim.

“Ia kaluam shumë bukur. Ishte shumë interesant dhe shumë cool,” thanë në fillim të bisedës, duke vijuar pastaj të ndajnë përshtypjet.

“Takuam shokë nga shkolla të ndryshme. Ishte interesante të dëgjosh se si ata u bënë pjesë e fushatës dhe cilat ishin arsyet që i kishin motivuar për tu bashkangjitur,” thotë Jana.



Ivan Ivanov, Dragana Janjic, Jana Georgievska dhe Nikola Todorovski

Që të katërt vullnetarisht u bënë pjesë e fushatës me idenë për të kontribuar në rritjen e vetëdijes mbi dhunën mes moshatarëve.

“Ta them të drejtën, kjo përvojë ka domethënie të madhe! Dhe, duke qenë se morëm pjesë, ne jemi kundër bullizmit dhe qëllimi që kemi është i qartë, por edhe u kënaqëm. Ndoshta ishte pak nxehtë por u argëtuam shumë,” shton Nikola.

Pas prezantimit zyrtar të fushatës, që u mbajt në 19 nëntor 2024, që të gjithë vunë re pjesëmarrjen e tyre. “Nuk më duhej të ndaja videon. Në momentin kur u shfaq në televizion, më kishte parë nëna ime, gjithë familja ime dhe të gjithë që më njohim në Shkup e kishin parë videon dhe të gjithë kishin mbetur me përshtypje të mira,” thotë Jana duke buzëqeshur.

Kur jemi tek prindërit, doja ta di reagimin e tyre për dëshirën që fëmijët shfaqën për të qenë pjesë e fushatës. Atëherë e mësova historinë e Draganës, që kishte qenë vetë viktimë e dhunës mes moshatarëve.



> “Kur ua thashë prindërve që do të bëhem pjesë e kësaj fushate, iu pëlqeu shumë si ide. Iu erdhi mirë ngaqë për shkak të problemit tim më të folurit më kanë përqeshur shpesh në shkollë fillore. Dikush që nuk më njihte mendonte që e bëja me qëllim, dhe kjo më shqetësonte shumë. Nuk e kisha të lehtë atëherë, por prindërit më mësuan që duhet të luftoj, t’ua shpjegoj të tjerëve që është pjesë imja dhe që është diçka që nuk mund ta ndryshoj,” kujton Dragana.

Sinqeriteti dhe pjekuria me të cilën foli ajo për këtë përvojë më mbushën me shpresë. Në qoftë se ‘’bota iu mbetet të rinjve’’, duhet të jemi të qetë – sidomos në qoftë se ua lëmë atë të rinjve me vetëdije mbi paragjykimet që ka shoqëria, dhe më e rëndësishmja të rinjve që janë të gatshëm të luftojnë kundër këtyre paragjykimeve.

Në atë moment, kurioziteti nuk më linte të pushoja, ndaj i pyeta: Si arritët në këtë pikë që të jeni kaq të vetëdijshëm për gjërat, ta kuptoni bullizmin në këtë mënyrë dhe të gjeni mënyra për ta shtypur atë? Gjithçka fillon me edukimin në shtëpi, ata ishin unanim, pastaj në shkollë.

> “Në shkollë fillore unë u gjenda në një situatë ku më futën në grackë që të dukem si bullizues. Në fund u dëshmua që nuk kisha faj, por atëherë e kuptova që mund të luftoja kundër kësaj dukurie në mënyrë që të mos më ndodhë një situatë e tillë përsëri. Por mendoj që gjithkush me mbështetjen e duhur në shtëpi nuk e ka të vështirë ta kuptojë dhe të ballafaqohet madje edhe me forma më të ashpra të dhunës’’, thotë Nikolla.



Dhuna mes moshatarëve është një dukuri që ndodh shpesh, por ajo që më befasoi gjatë bisedës me këta të rinj nuk ishte prezenca e kësaj dukurie – këtë tashmë e dimë – por fakti që sa të rinjtë e njohin këtë dukuri.

“Ka shumë dhunë mes moshatarëve, por njerëzit e kanë të vështirë ta dallojnë atë,” thotë Ivani, dhe pastaj Nikolla shton: “Bullizmi ndodh kudo, por shpesh nuk shihet si problem ngaqë gjithmonë normalizohet.”

Jana thekson një dimension tjetër:



> “Nuk ndodh vetëm në shkollë – njerëzit shpesh nuk e kuptojnë ndikimin që kanë fjalët që i thonë. Prandaj është me rëndësi që të ngrejmë zërin kur diçka nuk shkon.’’

Dragana, si pjesë e komunitetit të nxënësve, dëshmon që dhuna mes moshatarëve është një temë konstante nëpër takimet e tyre. Këto diskutime ia mundësuan që të sjellë këtë fushatë më afër nxënësve që nuk e kuptonin mesazhin.

Bullizmi në internet është një formë në rritje e dhunës mes moshatarëve, dhe doja ta di se ç'ndodh pasi diçka të postohet nëpër rrjetet sociale. A ngrejnë zërin nxënësit për viktimën apo ndjekin në heshtje se si do të zhvillohet ngjarja?

"Sot, ky është burimi kryesor i bullizmit. Përhapet shpejt – sapo të arrish në shkollë të gjithë e kanë marrë vesh," thotë Ivani.

Dragana ndau një shembull shqetësues: "Para dy vitesh, kishim një rast kur dy shokë klase, jo nga klasa jonë, kishin filmuar një vajzë me pengesa në zhvillim, kishin postuar videon dhe po talleshin me të. Ata u përjashtuan nga shkolla por vajza vazhdon të jetë e traumatizuar. Prandaj duhet të reagojmë para se të ndodhin gjërat."

Jana shton: "Nuk është e thënë të jetë një video – madje edhe vetëm një bisedë e thjeshtë mjafton të shpërndahet dhe viktima të izolohet dhe të ndjehet vetëm. E gjithë shkolla do e marrë vesh dhe ti bëhesh një lloj targeti. Në momente të atilla është e vështirë të gjehet mbështetje."
Derisa po bisedonim po e pyesja veten- meqë këta adoleshentë e njohin problemin, a kanë ndonjë zgjidhje?



Ivan Ivanov, Jana Georgievska, Nikola Todorovski dhe Dragana Janjic



> “Mendoj që duhet të futen dënime kundër gjuhës së urrejtjes. Sot, kushdo mund të shkruajë ç’të dotë në Internet, pa mbajtur asnjë përgjegjësi. Ka shtete ku kjo çështje është e rregulluar, duhet ta bëjmë këtë edhe këtu … ta marrim pak më seriozisht,” thotë Ivani.

Jana pajtohet që kjo mund të ndihmojë, sidomos me bullizmin në internet, por ajo mendon që zgjidhja afatgjate qëndron tek rritja e vetëdijes. “Është me rëndësi që viktima ta dijë që nuk është vetëm. Në qoftë se një person tregon që ka vetëdije, mund të inkurajojë të tjerët që ta kuptojnë që kjo që ndodh nuk është në rregull. Na duhen më shumë njerëz që nuk kanë frikë të ngrejnë zërin për gjërat që janë të drejta,” shton ajo.

Bisedës po i vinte fundi, por doja të dëgjoj edhe një herë mesazhet e tyre – çfarë do i thonin ata atyre që ndoqën fushatën, që lexojnë këtë intervistë apo që e njohin në ndonjë formë këtë çështje.

“Mendoj që dikujt i duhet të shohë fushatën disa herë në qoftë se nuk e kupton. Bëhet fjalë për një çështje vërtetë të rëndësishme – dhuna mes moshatarëve ndodh shpesh dhe për fat të keq, është normalizuar. Është koha që t’i themi ndal dhe të ngrejmë vetëdijën, jo vetëm tek ne por në tërë shoqërinë,” thotë Jana.

Nikolla shton: “Para se të themi ose të bëjmë diçka, na duhet të ndalojmë dhe të mendojmë. Të vëmë veten në vendin e tjetrit. Në qoftë se vetëm për një moment bëhemi të vetëdijshëm për atë se si ndjehet personi tjetër, mund të bëjmë një hap përpara drejt ndryshimit.”

“Shoqëria duhet të vetëdijësohet. Bullizmi lë shenja – jo vetëm fizike, por edhe psikologjike dhe këto të fundit janë më serioze. Na duhet të bëjmë kujdes për veprat që bëjmë ngaqë pasojat janë të përhershme,” paralajmëron Ivani.

Dragana, nga ana tjetër, e sheh fushatën si pasqyrë të realitetit ku jetojmë: “Gjithkush që sheh atë mund të shohë se në çfarë bote jetojmë dhe ç’lloj njerëzish na rrethojnë. Është me rëndësi që të angazhohemi me bisedat toksike, të ndalojmë bullizmin dhe të bëhemi të vetëdijshëm.”

Në qoftë se akoma nuk e keni parë fushatën, këta ambasadorë të rinj tashmë ua kanë sjellur më afër thelbin që ajo bart – dhuna mes moshatarëve është realitet që duhet ndryshuar. Ndiqni fushatën dhe mbani mend: " DHUNA MES MOSHATARËVE DUHET TË NDALOHET!"

LINKU PËR TË GALERIA

LINKU I VIDEOS







Duke kapur suksesin:

Një festim vizual











EKSPERTËT



JU PREZANTOJMË EKIPIN

INTERVISTA

KOMPONENTI 1

NË KËTË EKIP ASKUSH NUK MBETET PA MBËSHTETJE DHE UDHËZIM, NË THELB KEMI BESIMIN

Prezantojmë ekipin: Seanca e intervistave është menduar ashtu që prezantohet ekipi dhe ju njohim me anëtarët e ekipit të projektit ''Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit''.

Të qenit pjesë e Komponentit 1 do të thotë të punosh në një ekip me barazpeshë të përsosur mes ekspertizës ndërkombëtare dhe nacionale, gjë që mundëson këmbim të vazhdueshëm të ideve. Ekspertët brenda këtij Komponenti janë të dedikuar ndaj forcimit të sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut duke rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien e tij. Përmes angazhimeve të ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë dhe atyre të vendit, synohet qëllimi për ndërtim të besimit publik dhe zbatimi i një gjyqësori si bazë e drejtë për një shoqëri të drejtë.

Në këtë edicion të Prezantojmë ekipin, biseduam me Slaven Lekic dhe Goce Kocevskin, ekspertë në Ministrinë e Drejtësisë; Boro Ilkoskin, ekspert nga Prokuroria Publike; Kiril Qiroskin dhe Miroslav Gembickin, ekspertë të IT për institucionet e gjyqësorit; dhe Voislav Stojanovskin, ekspert për gjyqësorin. Ata ndanë hollësitë e punës së tyre, sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe ndikimin që kontributi i tyre ka dhënë për reformën në gjyqësor.

Si është të jesh pjesë e Komponentit 1, në bashkëpunim me një ekip ekspertësh nga fusha të ndryshme? Ç'përfitime ka puna juaj nga kjo qasje multidiciplinore?

Siç tha Slaven Lekici, kjo përbërje mundëson bartje të vazhdueshme të njohurive, duke siguruar që askush nuk mbetet pa mbështetje apo udhëzime. Voislav Stojanovski e sheh këtë si një mjedis ku ndahen idetë, ku je i rrethuar me persona të talentuar, ku roli i tij shtrihet përtej aspekteve ligjore. Ai i lidh gjërat duke shqyrtuar se vallë ndonjë politikë do të qëndronte në Strazbur apo mbi mënyrën se mund t'iu jepet fuqi gjykatësve të vendosin për efikasitetin pa u ngarkuar shumë nga Këshilli Gjyqësor.


Kiril Qiroski dhe Miroslav Gembicki theksojnë që kjo qasje multidiciplinare ushqen mënyra të reja të të menduarit dhe zgjidhjes së problemeve, duke u siguruar që një sërë perspektivash dhe njohuritë e specializuara integrohen në proceset vendimmarrëse.

Duke bërë bashkë ekspertë nga fusha të ndryshme, ekipi gjen zgjidhje të kompletuara, gjë që çon drejt një shqyrtimi më efektiv dhe kreativ të zgjidhjes së sfidave komplekse. Boro Ilkoski thekson nderin dhe përgjegjësinë që vijnë duke qenë pjesë e një ekipi kaq të dalluar, duke nënvizuar aspektin e veçantë që ka puna e tyre: integrimin e standardeve ndërkombëtare me nevojat e vendit. Kjo qasje iu mundëson të përshtaten dhe të rafinojnë rekomandimet që japin, duke e bërë punën e tyre të dallohet nga çdo projekt tjetër.

Për Goce Kocevskin, kontributi në reformën në gjyqësor është si sfidues ashtu edhe pozitiv, sidomos kur bashkëpunon me kolegë kaq të aftë. Liria për të diskutuar idetë pa hezituar, të mendosh jashtë kornizave të zakonshme, të mësosh nga të tjerët janë gjëra që u shtojnë vlerën angazhimeve të tyre. Fryma bashkëpunuese e ekipit është një forcë nxitëse, gjë që bën punën e tyre me ndikim dhe me mundësi për të transformuar sistemin juridik.

Kur duhet bërë përshkrim i frymës ekipore brenda Komponentit 1, çdo ekspert ndan një ndjenjë uniteti që tejkalon fushat e ndryshme nga të cilat vijnë. Çdo anëtar sjell këndvështrim unik, dhe forca e tyre kolektive buron nga mënyra se si mbështesin njëri tjetrin dhe se si punojnë së bashku drejt qëllimeve të përbashkëta.

Slaven Lekici e shpjegon këtë më së miri me fjalën "Besim," që pasqyron besimin e thellë që është ndërtuar me kalimin e kohës, sidomos duke tejkaluar sifda të ndryshme së bashku. Ky besim bën që ata të mbështeten tek njëri tjetri si në situata komplekse ashtu edhe në përditshmëri. Për Voislav Stojanovin, është fjala "katalizator" ajo që shpjegon më së miri thelbin e ekipit. Ai nuk i sheh ata vetëm si ekspertë por edhe si agjentë të transformimit që nxisin ndryshme që askush nuk do të mund t’i arrinte individualisht.



Kiril Qiroski dhe Miroslav Gembicki pajtohen, dhe zgjedhin fjalën "Sinergji" për të përshkruar forcën kolektive që ka ekipi. Ata besojnë që kontributi i secilit anëtar thekson angazhimet e të tjerëve, duke nxitur inovacionin dhe zgjdhjen e problemeve që tejkalonë atë që mund të zgjidhet nga vetëm një fushë e vetme diciplinore. Boro Ilkoski zgjedh fjalën "Proaktive," për të theksuar qasjen e të menduarit avantgard që ka ekipi, duke paraparë gjithmonë nevojat dhe duke i dalë përpara proceseve. Për Goce Kocevskin, është fjala "Kolegialitet" ajo që duhet theksuar, që përfaqëson mjedisin bashkëpunues ku secili është gati të ndihmojë dhe të mbështesë tjetrin.

Bashkë, këto fjalë përbëjnë një pikturë të një ekipi dinamik, mbështetës dhe punëtor që synon të ketë bashkëpunim dhe të arrijë qëllime të përbashkëta.

Si vazhdë e bisedës së frymës ekipore, flasim për atë se si do përshkruanin ndikimin që Komponenti 1 ka me vetëm tri fjalë, ekipi reflekton mbi rezultatet e prekshme dhe përpjekjet për bashkëpunim që përkufizojnë misionin e tyre.

Slaven Lekic theksoi angazhimet e ekipit për aktivitete të prekshme, të mundshme dhe reale që rezultojnë me ndikime të matshme. Voislav Stojanovski nënvizoi forcën që shtyn punën e tyre: momentumi, bashkëpunimi, dhe reformat. Për Kiril Qiroskin dhe Miroslav Gembickin, shtrirja e gjerë, bashkëpunimi dhe ndikimi janë fjalët që përshkruajnë më së miri qasjen e tyre, ngaqë Komponenti 1 ka një vështrim gjithëpërfshirës mbi përmirësimet në gjyqësor—rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit duke nxitur partneritet mes institucioneve dhe diciplinave për të krijuar ndryshime domethënëse për palët përfituese. Boro Ilkoski sheh angazhimin e tyre si të besueshëm, diçka me ndikim, dhe si diçka që ofron transformim, kurse Goce Kocevski përkufizon atë si të dalluar, të rëndësishëm dhe të çmuar.

Me punën e tyre mbulohen fushat thelbësore në reformën e gjyqësorit, që nga zhvillimi i strategjive dhe avancimeve të IT e deri tek masat diciplinore. Por me një shtrirje kaq ambicioze edhe sfidat janë të paevitueshme. Cili ka qenë aspekti më i vështirë i kësaj pune dhe si është ballafaquar ekipi me të?

Slaven Lekic thotë që edhe përkrah përfshirjes aktive të palës përfituese dhe marrjes përsipër të pronësisë gjatë procesit, progresi është ndikuar nga vonesat për shkak të zgjedhjeve, problemeve me BNJ dhe implikimet buxhetore.

Voislav Stojanovski thekson vështirësinë për të harmonizuar afatet e caktuara dhe prioritetet mes degëve të ekzekutivit, parlamentit dhe gjyqësorit. Ekipi është përpjekur të mbushë këto zbrazëtira duke organizuar tryeza diskutimi, sidomos gjatë hartimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

Kiril Qiroski dhe Miroslav Gembicki theksojnë sfidën e integrimit të zgjidhjeve digjitale brenda kornizave ekzistuese ligjore, ku kanë hasur rezistencë ndaj ndryshimeve dhe inercion institucional, gjatë balancimit të kërkesave strategjike dhe legjislative.

Boro Ilkoski thekson rëndësinë e ndryshimit të mënyrës së të menduarit nga qasjet e vjetëruara, duke nënvizuar që përmirësimi i praktikave ligjore kërkon edhe ndryshim më të gjerë kulturor.
Goce Kocevski sheh sfidën e vërtetë tek transformimi i mendësisë së gjyqësorit në një mendësi që rezulton si profesioniste, llogaridhënëse, dhe e qëndrueshme, dhe jo me fokus të vetëm në ndryshimin e ligjeve apo marrjen e mjeteve të reja për IT.

Edhe përkrah këtyre vështirësive, ekipi vazhdon të jetë i angazhuar për të çuar përpara reformat përmes bashkëpunimit dhe qasjes multidiciplinore.

Si mbështesni njëri tjetrin gjatë bashkëpiunimit me institucionet gjyqësore që lidhen njëra me tjetrën, për tu siguruar që reformat brenda Komponentit 1 zbatohen si pjesë e një strategjie kohezive dhe jo të izoluara?

Slaven Lekic theksoi natyrën mendjehapur dhe bashkëpunuese që ka ekipi, ku espertët janë të gatshëm për të ndarë përvojat, për të kërkuar këshilla dhe për t'i ofruar mbështetje njëri-tjetrit.





Voislav Stojanov theksoi rëndësinë që kanë takimet e rregullta për koordinim, ngjarjet e përbashkëta dhe këmbimi i vazhdueshëm i praktikave të mira për të dhënë mbështetje konsistente në çdo institucion. Përmes punës këshilluese dhe trajnimit nga kolegët, ekipi ushqen bashkëpunimin duke u siguruar që reformat janë në përputhje me vizionin e unifikuar dhe nuk paraqesin vetëm aktivitete të fragmentuara.

Kiril Qiroski dhe Miroslav Gembicki, që bashkëpunojnë me të gjitha palët përfituese të Komponentit 1, theksojnë vlerën që ka komunikimi i hapur, njohuritë që ndahen me njëri-tjetrin dhe qasja e koordinuar. Duke kuptuar sfidat e posaçme dhe prioritetet që ka çdo institucion, ato mundësojnë krijimin e sinergjive që nxisin reforma të gjera në gjyqësor, duke siguruar kështu që përmirësimet në një fushë ndikojnë në përmirësimin e fushave të tjera.

Boro Ilkoski nënvizoi që natyra e ndërlidhur e sistemit të drejtësisë kërkon bashkëpunim dhe koordinim mes gjykatave, mes zyrave të prokurorive publike, Këshillit Gjyqësor, dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Me trajtim të këtyre sfidave të përbashkëta, Komponenti 1 ka një rol të rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Për Goce Kocevskin, thelbi i bashkëpunimit qëndron tek ndarja e informacionit dhe tek mirëmbajtja e qasjes së koordinuar, duke forcuar angazhimin e ekipit për një gjyqësor më transparent, efikas dhe llogaridhënës.

Cilat janë prioritetet që keni caktuar për të ardhmen për Komponentin 1, dhe cili është impakti që shpresoni të arrini?

Slaven Lekic theksoi qasjen e kujdesshme dhe reale, me fokus në krijimin e një mjedisi ligjor të qëndrueshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në mbështetje të aspiratave që Maqedonia e Veriut ka për anëtarësim në BE.

Për Voislav Stojanovskin, rivitalizimi i Strategjisë së Këshillit Gjyqësor për Menaxhim me Burimet Njerëzore është një fokus thelbësor. Miratuar në vitin 2020, nuk është zbatuar në kohë, por tani përmes një analize të hollësishme të rrjetit gjyqësor, sistemit për punësim dhe trajnimeve, qëllimi që synohet është të optimizohet ndarja e resurseve. Duke trajtuar mungesën e gjykatësve dhe duke zhvilluar rrugë të qarta të ndërtimit të karrierës, ky angazhim do të sigurojë që gjykatat të kenë numër të mjaftueshëm të punonjësve, që përputhen me qëllimet për integrim në BE dhe që ndërtojnë besimin publik në gjyqësor.

Kiril Qiroski dhe Miroslav Gembicki theksojnë avancimin e digjitalizimit si prioritet parësor. Fokusi është tek rritja e planifikimit strategjik të IT-së, forcimi i koordinimit institucional dhe rritja e transparencës. Integrimi i zgjidhjeve bashkëkohore teknologjike do të bëjë që sistemi të jetë më efikas, më i qasshëm, dhe më llogaridhënës, duke mbështetur kështu një sistem drejtësie që ka në thelb sundimin e ligjit dhe që ushqen besimin e opinionit publik.

Boro Ilkoski thekson që Zyra e Prokurorit Publik dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë po ballafaqohen me sfida mjaft të mëdha. Transparenca dhe llogaridhënia në këto institucione do të jetë në fokus, me qëllimin kryesor të transformimit të perceptimit publik dhe sigurimit që këto institucione punojnë me më shumë efikasitet dhe integritet.

Për Goce Kocevskin, prioriteti është i qartë: rritje e dukshme e besimit publik tek gjyqësori, një qëllim që është bazë e punës brenda Komponentit 1 dhe që do të shënojë suksesin e angazhimeve brenda këtij komponenti.





SHKURT - MAJ 2025

KALENDARI
NGJARJET E ARDHSHME

12 PRILL – **14 PRILL**

trajnim mbi aftësitë e prezantimit për grupin e punës për relacione me publikun për shërbimin e provës

Komponenti 4

MAR

Prezantim i Strategjisë së Komunikimit për Zyrën e Prokurorit Publik

Komponenti 1

02 PRILL

Forumi i Përfituesve për të Drejtat e NJeriut

Komponenti 4

IMPRINT

Botues: Ludwig Boltzmann Gesellschaft – Instituti i të Drejtave Themelore dhe të Drejtave të Njeriut (LBI-GMR), Vienë, në kuadër të projektit ‘’Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit’’, Shkup

Redaktore: Kristina Vesikj

Lektorimi: Ane Petrushevska

Periudha e raportimit: 08 nëntor 2024 - 07 shkurt

Data: 07 shkurt 2025

Financuar nga Bashkimi Evropian